



**RRJETI I GRUPEVE TË GRAVE TË KOSOVËS
RAPORTI VJETOR 2004**

RRJETI I GRUPEVE TË GRAVE TË KOSOVËS RAPORTI VJETOR 2004



Shkruar nga Elita Gota
Koncepti nga Jessica Glynn
Redaktimi & Radhitja nga Nicole Farnsworth
Financuar nga Kvinna till Kvinna dhe nga
Zyra Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim

MISIONI YNË



RRGGK-ja mbështet, mbron dhe promovon të drejtat dhe interesat e grave dhe të vajzave në tërë Kosovën, pavarësisht nga orientimi politik, religjioz, niveli i arsimimit, mosha, orientimi seksual apo aftësitë e tjera. RRGK-ja përmbush misionin e saj me anë të këmbimeve, përvojave, informatave, avokimeve, partneritetit, rrjetëzimeve dhe hulumtimeve.

PËRMBAJTJA

Letra nga Kryesuesja e Bordit	4
Anëtarët e Bordit 2004	5
Letra nga Drejtoresha Ekzekutive	6
Misioni Ynë	8
Hyrja	9
Objektivat Strategjike	
Mbështetësit e RRGK-së	10
Programet dhe aktivitetet në 2004	11
Ngritja e Kapaciteteve Institucionale	11
Këmbimet e përvojave dhe rrjetëzimet	12
Ngritja e pjesëmarrjes së Gruas në Politikë	14
Mekanizmat Ligjorë	16
Të drejtat e Grave	16
Programet të ndryshme	18
Programet e ardhshme	19
Personeli	20
Anëtarët e RRGK-së	21
Raporti Financiar	26
Shpenzimet	27

LETËR NGA KRYESUESJA E BORDIT

Të nderuara anëtare të Rrjetit,

Si kryetare e Bordit të Grupeve të Grave të Kosovës, kam nderin t'ju drejtohem përmes buletinit të këtij Rrjeti dhe të shpreh kënaqësinë për punën tuaj kreative që ju si anëtare të Rrjetit e keni bërë gjatë vitit 2004. Mund të them lirisht se RRGK me më shumë se 70 organizata dhe grupe të grave ka arritur suksese të konsiderueshme në fushën e avancimit të pozitës së gruas në të gjitha segmentet në shoqërinë Kosovare.



RRGK ka arritur ta bëjë këtë me vullnetin që kishte për punë në arritjen e synimeve të veta, mirëpo kësaj i kontribuoi në një masë shumë të madhe edhe vetë Drejtoresha Ekzekutive e Rrjetit zonjusha Igballe Rogova.

Gjatë vitit 2004 Rrjeti ishte zbatues i aktiviteteve të shumta të cilat u realizuan me shumë sukses. Ndërmori shumë fushata, ndër to mund të veçohen: “Gratë propozojnë”, fushatë kjo që synonte përfshirjen e perspektivës gjinore në programet e partive politike; “Ato guxojnë të flasin” - fushatë për vetëdisimin e grave për të drejtat e tyre etj. RRGK bashkëpunoi edhe me Reforma 2004 dhe “Lobin e Grave të Kosovës” për reformën e Ligjit Elektorale. RRGK organizoi konferenca rajonale për mekanizmat për barazi gjinore. Realizoi shumë punëtori ndër to edhe punëtorinë për “Zbatimin e rezolutës 1325”. Të gjitha këto programe dhe shumë tjera që nuk përmenden këtu RRGK i realizoi me shumë sukses duke u bërë një partner i denjë i institucioneve qeveritare vendore dhe atyre ndërkombëtare.

Besoj se edhe viti 2005 do të vazhdojë të shënojë suksese edhe më të mira duke shpresuar se edhe më tutje do të na mbështesin faktori politik vendor dhe ndërkombëtar.

Me respekt,

Naxhije Buçinca
Kryetare e Bordit të RRGK së

ANËTARËT E BORDIT 2004

Kryesuese - Naxhije Buçinca
Drejtoreshë e Grupit të Grave Vetëranë të Arsimit

Delina Fico
Drejtoreshë, Star Network of World Learning

Marta Prekpalaj
Drejtoreshë e Programit, Morat Qiriaz

Luljeta Vuniqi
Menaxhere e Programit, Fondacioni Kosovë për Shoqëri të Hapur

Vjosa Dobruna
Kryesuese e Bordit të Radio Televizionit të Kosovës

Flora Macula
Menaxhere e Programit vendor nga UNIFEM-i

Argjentina Grazhdani
Këshilltare për Media dhe Shoqëri Civile në USAID



Anëtarët e Bordit nga e majta në të djathtë: Luljeta Vuniqi, Flora Macula, Marta Prekpalaj, Delina Fico, Argjentina Grazhdani, Naxhije Buçinca, Vjosa Dobruna, and Igballe Rogova.

LETËR NGA DREJTORESHA EKZEKUTIVE



Të dashura anëtare dhe miq te Rrjetit,


Që nga takimi ynë i parë i Rrjetit të Gruas në janar të vitit 2000, ju keni bërë përpjekje, keni shfaqur angazhimin tuaj dhe keni siguruar energji shtesë në mënyrë që Rrjeti ta vazhdojë punën.

Njeriu për të arritur sukses në jetë I nevojitet përkrahja e prindit, motrës, vëllaut apo burrit. Mua personalisht më ka motivuar e përkrahur nëna ime. Ajo grua e thajshme por e fortë dhe energjike jetën e saj të përvuajtur e me plot sakrificë e kishte fshehur në brendinë e qenies së vet, duke u përkujdesur që neve vajzave (gjasthtë) të na përkrahe qoftë për shkollim qoftë në përballjet me jetën. Na rriti dhe na edukoi në frymën e dashurisë e bamiresisë. Ajo na hapi dyert që të ecim të lira e të pa varura. Ajo grua me aq pak shkolle ishte keshilltare e mirë e familjes, por u ofronte ndihmë edhe tjerëve kur kishin nevojë. Vullneti I saj I çeliktë që të na aftësojë për jetë, guximi I saj kur përballej me situatë të vështira të jetës, më kanë motivuar të orientohem në këtë mision human. U angazhova me tërë qenien (duke lënë anash jetën time private) të ndryshoj në të mirë jetën e grave kosovare. Fatet e problemet e tyre u bën pjesë e jetës sime, brengat e tyre u bëne e përditshmja ime.

Kur nëna ime nderroi jete ne 2003, mendova se humba prijësen time, se pa te s'do të mund të realizoja betimin që I kisha dhënë vetes - t'u ndihmojë grave në përmisimin e jetës së tyre. Tre muaj u përpëlita e shqetësuar me vetëveten se si mund ta vazhdoj detyrën time pa përkrahësen - nënë, por ajo s'më kishte lënë. Shpirti I saj filloi të jetoj brenda meje duke më paralajmëruar se misionin që kisha filluar nuk duhet ta ndërprisja, por të vazhdoja me ngulm në realizimin e saj. T'ia shtrish dorën një njeriu është vepër humane, por t'ia ndriçosh mendjen një gruajë që ka jetuar në skëterr është detyrë e shenjtë. . .

Që të mos jem vetëm kërkova ndihmën e një mikeshë, pastaj edhe një tjetre edhe shumë të tjerave e keshtu vazhduam Rrjetin. Rrjet të fortë e të motivuar për të ndryshuar jetën e grave, rrjet të organizuar që do të ngre zërin fuqishëm kundër diskriminimit, dhunës, padrejtësisë, trafikimit. . . Rrjet që për një kohë të shkurte do të realizojë aspiratat e çdo gruajë : shkollimin, punësimin, barazinë mes gjinive, avansimin në pozita vendim marrëse. . .

Në vjeshtën e vitit 2003 se bashku I hymë procesit të regjistrimit të Rrjetit. Edhe pse në mënyrë jozyrtare funksiononte që nga vitit 2000 dhe gratë mbledheshin edhe më herët në Rrjetin e Grave Rurale, 1997, Rrjeti zyrtarisht i regjistruar, e ngriste zërin tonë në vendim-marrje. Nuk



ishim më një rrjet joformal i grave por një rrjet i institucionalizuar, me zyrë të njohur, me të punësuar të pëthershëm dhe orar të caktuar pune.

Statusi ynë i ri solli njohje me të gjerë nga Misioni Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK-u) dhe nga Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE)- dy vendimmarrësit kryesor në Kosovë si dhe nga disa institute të tjera kombëtare e ndërkombëtare. Kështu, viti 2004 shënoi fillimin e një periudhe të re për Rrjetin e Grave të Kosovës. Në vitin 2004, anëtarët tona, partnerët, miqtë dhe përkrahësit me përpjekje të përbashkëta arritën që zërat e grave kosovare të dëgjohen- që nga asambleja komunale vendore deri tek Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara në Nju Jork. Në vitin 2004, ndryshe nga

Përfaqësuesit e mëparshëm Special të Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara, përfaqësuesi i ri, Soren Jessen Peterson e ftoi shoqërinë civile dhe në mënyrë të veçantë gratë, që të takoheshin me të. Në këtë mënyrë, ai avancoi zbatimin e Rezolutës 1325 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara për Gratë, paqen dhe sigurinë në Kosovë. Përvoja jonë me Përfaqësuesin aktual të Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara dhe me ata të mëparshmit dhe me vendim marrësit e tjerë ndërkombëtarë, ka treguar se arritja e barazisë gjinore nuk varet vetëm nga themelimi i institucioneve. Në këtë mënyrë të rëndësishme janë individët brenda këtyre institucioneve dhe vullneti tyre për të bërë ndryshime. Soren Jessen Petersen ka treguar angazhimin për zbatimin e Rezolutës 1325 dhe kjo duhet të shërbejë si shembull për katër Përfaqësuesit Special të mëparshëm të Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara dhe secilit që do të vijë më pas - në Kosovë apo kudo tjetër në botë.

Si përfundim, dua të theksoj se janë individët ata që e kanë bërë punën tonë të suksesshme. Puna jonë është personale. Është çdo anëtar i Rrjetit të Grupeve të Grave Kosovare, çdo person i cili ia ka kushtuar kohën dhe përpjekjet punës së rrjetit, çdo përkrahës, çdo partner dhe çdo mik që ka treguar angazhim që të arrihet barazia gjinore në Kosovë. Dedikimi i tyre na ka ndihmuar për të hedhur çdo hap para. Pra, urime të gjitha juve - 2004-ta ka qenë suksesi juaj.

Vazhdoni punën e suksesshme!

Igballe Rogova
Drejtoreshë Ekzekutive
Rrjeti i Grave të Kosovës



RRJETI I GRUPEVE TË GRAVE TË KOSOVËS (RRGGK)

RRGGK është themeluar në vitin 2000 si rrjet jo formal i grave të Organizatave jo qeveritare (OJQ) nga tërë Kosova. Që nga nisma e saj RRGGK është shndëruar në një rrjet të rëndësishëm që avokon në emër të grupeve të grave dhe organizatave jo qeveritare nëpër gjithë Kosovën. Deri në fund të 2004, RRGGK përbëhej nga 70 grupe dhe OJQ të grave, disa prej të cilave ishin shumë mirë të organizuara dhe kishin më shumë se dhjetë vjet përvojë në zhvillimet e komunitetit. Rrjeti gjithashtu përfshin edhe gra nga grupet e ndryshme etnike dhe u ndihmon atyre që ti ngrisin kapacitetet e tyre, për të punuar si dhe ta ngrisin zërin në emër të Komunitetit të tyre.

Anëtarët e rrjetit ofrojnë shërbime nga më të ndryshmet për gratë në komunitete si kurse dhe hulumtime, trajnime dhe ndihmë psikologjike. Poashtu me programe sociale të cilat ndikojnë sot tek gratë dhe vajzat, duke përfshirë dhunën ndaj gruas, trafikimi i femrave, dhe arsimimi i mesëm dhe i lartë i vajzave. Anëtarët e RRGGK-së shumë shpesh avokojnë në nivelin lokal në emër të grave dhe të familjeve të tyre.

OBJEKTIVAT STRATEGJIKE 2005-2008

Objektivat strategjike të RRGGK për 2005 - 2008 janë:

- Ngritja e vetëdijes tek Gratë dhe Burrat për të Drejtat e Gruas dhe mundësit për arritjen e barazisë gjinore në Kosovë.
- Rritja e pjesëmarrjes së barabartë dhe efektive të gruas në të gjitha nivelet e jetës politike dhe proceset vendim marrëse.
- Rritja e efektivitetit të legjislacionit, programeve qeveritare dhe politikave për arritjen e barazisë gjinore në Kosovë.
- Rritja e kontributit të gruas dhe njohja publike e kontributeve të saja për arritjen e paqes dhe stabilitetit në Kosovë dhe rajon.
- Fuqizimi i lëvizjeve të grave në Kosovë dhe rritja e rolit të saj në rajon dhe Botë.



PËRKRAHËSIT TANË

RRGGK përkrahet nga individ dhe organizata të ndryshme të cilat ofrojnë përkrahje morale, teknike dhe përkrahje të tjera për rrjetin. RRGK-ja shumicën e sukseseve të saj i atribuon përkrahjes dhe përkushtimit të përkrahësve të organizatës saj. Ne do të kishim dëshirë që ti shënojmë

emrat e të gjithë personave të cilët kontribuan për Rrjetin por me atë rast lista do të jetë e pa fund. Ju lutemi ta keni para sysh që ne e vlerësojmë punën dhe angazhimin tuaj dhe të gjithë atyre të cilët e kanë mbështetur dhe financuar RRGK në dhe aktivitete e saj në vitin 2004.

Programi Kosovar për Iniciativa Lokale (KLIP)

STAR Network World Learning

Fondacioni Kosovar për Shoqëri të Hapur (KFOS)

UNIFEM

Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE)

Zyra Zvicerane për Bashkëpunim

Agjensioni Suedez për Bashkëpunim Ndërkombëtar (SIDA)

Agjensioni Kanadez për Bashkëpunim Ndërkombëtar (CIDA)

UNICEF

UNDP

Fondacioni për Iniciativë Demokratike (FDI)

Fondacioni Heart and Hand

Kvinna till Kvinna (KtK)

Urgent Action Fund

PARTNERËT TANË

Përveç përkrahësve tanë të rregullt ne bëjmë partneritet edhe me organizatat në vijim në mënyrë që të koordinojmë punëtori, fushata dhe projekte të ndryshme. Partnerët tanë kanë formuar një bazë të gjerë të rrjeteve regionale dhe ndërkombëtare që na mundësojnë që të kemi kontakte; të këmbëjmë informata me gratë nga tërë bota të cilat kanë probleme, objektiva dhe qëllime të ngjashme. Këto partneritete mundësojnë që të dëgjohet zëri i RRGK së në forume joqeveritare ndërkombëtare. Partneriteti jonë me organizatat në vijim në 2004 ka qenë shumë i suksesshëm.

Antico (Shkup)

Rrjeti i Grave nga Shqipëria

Qendra Autonome e Grave - Beograd

Rrjeti i Grave nga Bosnia and Hercegovina

Qendra për Gratë Viktima të Luftës (Zagreb)

Rrjeti i Grave nga Kroacia

KTV

Rrjeti i Grave të Maqedonisë "Together"

Rrjeti i Grave Juglindore

Instituti për Shoqëri të Hapur - Nju Jork

RTK

RTV 21

Urgent Action Fund

Qendra e Gruas (Tiranë)

Zene Zenama (Sarajevë)



Falenderim i veçantë për RTV21 për përkrahjen e tyre gjatë 2004. Nga e majta në të djathtë: Afërdita Kelmendi dhe Xheraldina Vula

PROGRAMET DHE AKTIVITETET

NGRITJA E KAPACITETEVE INSTITUCIONALE

Me 9 dhjetor 2003, Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës mbajti mbledhjen e parë vjetore të anëtarësisë, në Prishtinë. Gjatë mbledhjes, më shumë se 50 anëtare dhe përkrahëse të Rrjetit diskutuan mënyra të ndryshme për të ndërtuar rrjetin dhe anëtarësinë e tij. Anëtarët e Rrjetit po ashtu zgjodhën Bordin e parë të RRGGK, i cili përbëhej nga 7 anëtare. Gjatë takimit të parë, Bordi zgjodhi Naxhije Buçincën si kryesuese të Bordit.

Në janar të vitit 2004, RRGGK, e hapi zyrën e parë në Prishtinë me përkrahje të STAR Network of World Learning, Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur dhe Programi kanadezo-kosovar për iniciativë vendore. Rrjeti pastaj, ndërroi zyrat në shtator të vitit 2004 në lokacionin e tanishëm në qendër të Prishtinës.



Plani strategjik me anëtarët e Bordit dhe stafin e Rrjetit.



Numrimi i votave për zgjedhjen e anëtarëve të ri të Bordit.

Në vitin 2004, RRGGK po ashtu angazhoi anëtare dhe partnerë në procesin e planifikimit strategjik, që rezultoi me planin strategjik të RRGGK-së për 2005-2008. Nisma e këtij plani ishte në Gjakovë, ndërsa finalizimi u bë në Prishtinë në muajin tetor. Plani strategjik përfshin objektivat e RRGGK-së, programe, partnerë, dhe strategji për shtim fondesh për tre vitet e ardhshme.

RRGGK ka mbajtur mbledhjen e dytë vjetore të anëtarësisë me 4 dhjetor të vitit 2004 në Prishtinë. Gjatë kësaj mbledhjeje, RRGGK, paraqiti draft raportin vjetor dhe planin strategjik të RRGGK-së. 90 anëtare të RRGGK-së dhe përkrahës, të cilët morën pjesë në mbledhje siguruan të dhëna për punën e deritashme të RRGGK-së dhe diskutuan projekte për vitin 2005. U zgjodhën dy anëtare të reja të Bordit dhe të tjerat u rizgjodhën.

RRJETËZIMI DHE SHKËMBIMI I PËRVOJAVE

Që nga shkurti i vitit 2004, RRGK, e zgjeroi anëtarësinë e saj nga 42 në 70 organizata. Kjo u bë përmes takimit të rrjetit dhe bashkëpunimit në fushata. Anëtarët e RRGK-së, shumë prej të cilave i filluan përpjekjet e tyre për rrjetëzim në vitin 1995, vazhduan ti vizitonin, ndanin përvojat dhe përkrahnin organizatat e grave në vendet e rajonit dhe ndërkombëtarisht. Në vitin 2004, anëtarët e RRGK-së u takuan me përfaqësuesit e organizatës së grave nga Bosnja e Hercegovina, Maqedonia, Serbia, Kroacia, Mali i Zi. Qëllimi i këtyre vizitave ishte këmbimi i përvojave dhe diskutimi i strategjive për përfshirje të mëtejshme të grave në përpjekjet për ndërtimin e paqes në Evropën juglindore.

DERI NË FUND TË VITIT 2004, RRGK KA RRIUR ANËTARSIMIN PREJ 42 NË 70 ORGANIZATA.

TAKIME DYMUJORE KOORDINIMI

RRGK ka mbajtur mbledhje koordinimi dymujore me anëtarët e rrjetit, organizatat ndërkombëtare, dhe OJQ-të vendore me 5 janar, 1 mars, 3 maj, 5 korrik, 6 shtator, dhe 5 nëntor. Gjatë këtyre takimeve RRGK ka siguruar të dhëna për programet e rrjetit dhe aktivitetin e tij. Takimet po ashtu kanë shërbyer si forum për pjesëmarrësit për të shkëmbyer informacion dhe përvojë si dhe të inicohen aktivitete të përbashkëta.

BULETINI “ZËRI I GRUAS KOSOVARE”

Buletini tremujor i RRGK-së, “Zëri i Gruas Kosovare”, u botua në prill, korrik, dhe tetor të vitit 2004. Buletini u shpërnda në mënyrë elektronike në gjuhën shqipe, angleze dhe serbe. Vlerësimi pozitiv për buletin, që morëm nga Z. Michael Jay, nënsekretar permanent në zyrën britanike, është dëshmia më e mirë e qëllimit dhe efektiviteti të “Zërit të Gruas Kosovare”.

“**ËSHTË INKURAJUESE TË SHOHËSH NJË RRJET KAQ AKTIV TË GRAVE NË KOSOVË, I CILI PËRKRAHË BARAZINË GJINORE.**”

- SIR MICHAEL JAY

QËLLIMET ZHVILLIMORE TË MILENIUMIT

Në shkurt 2004, RRGK udhëtoi për në Tiranë me anëtarët e qeverisë së Kosovës, parlamentit, dhe shoqërisë civile. Delegacioni kosovar, vizitoi ministri të ndryshme, për të mësuar se si “Platforma e Qëllimeve Zhvillimore të Mileniumit” kishte funksionuar në Shqipëri. Qëllimi i kësaj vizite ishte të identifikohen mënyrat se si qeveria, shoqëria civile dhe komuniteti mund të bashkëpunojnë në përmbushjen e Qëllimeve Zhvillimore të Mileniumit. Udhëtimi u organizua nga UNDP në Kosovë.

PËRKRAHJE PËR RRJETIN E GRAVE SERBE “ZORA”

RRGK ka bashkëpunuar me Rrjetin e Grave Serbe “Zora”, për të organizuar punëtorinë e quajtur “Menaxhimi i OJQ-ve në Mjedisin e Ri Ligjor”, me 20-21 shkurt. Kjo punëtori ka siguruar mundësinë për gratë shqiptare dhe serbe që të diskutojnë problemet dhe brengat e përbashkëta dhe mënyrat e përfitimit nga puna dhe përvoja e njëra-tjetrës. STAR Network of World Learning ka siguruar ndihmën financiare dhe teknike.

ASISTENCA PAS TRAZIRAVE TË MARSIT NË KOSOVË

Pas trazirave të marsit 2004 në Kosovë, anëtarët dhe miqtë e RRGK-së dhuruan 900 euro dhe 350 \$ për të ndihmuar familjet shqiptare dhe serbe që u dëmtuan nga dhuna. Përfitues ishin familja Veseli në Qabër/Mitrovicë, fëmijët e të cilës ranë në lumin Ibër, duke i paraprirë dhunës dhe familja e Nevenka Rikolos, në Fushë Kosovë, shtëpia e të cilës u dogj me 18 mars. Nevenka Rikolo është koordinatore e shoqatës “Ruka Ruci” dhe është anëtare e RRGK-së.

PEKIN +10

2005-ta shënon 10 vjetorin e Deklaratës së Pekin dhe Platformës për Veprim e adoptuar në Konferencën e Katërt Botërore të Grave, të mbajtur në Pekin, në shtator 1995: Deklarata dhe Platforma për Veprim, definojnë qëllimet ndërkombëtare për avancimin e grave, barazinë gjinore, zhvillimin dhe paqen për të gjitha gratë e botës. Në Pekin + 10 Kombet e Bashkuara kanë rishikuar progresin e bërë që nga fillimi i Deklaratës dhe Platformës për Veprim dhe të rikonfir-

muar angazhimin e botës për barazinë e grave.

RRGK-ja ka dërguar tri gra që të marrin pjesë në forumin e OJQ-ve, Përmbledhjes Përgatitore Rajonale në Pekin +10, të mbajtur në Gjenevë me 12-13 dhjetor. Temat kryesore ishin: gratë në ekonomi, mekanizmat institucional për promovimin e barazisë gjinore, trafikimi i grave në kontekstin e lëvizjeve migruese, dhe çështjeve rrjedhoj. Pjesëmarrja e grave kosovare në këtë takim u financua nga UNDP.

BASHKËPUNIMI ME RRJETIN RAJONAL TË GRAVE

Këto vizita bashkëpunimi kanë pasur qëllim të identifikojnë rrugët për përfshirjen e grave në negociata paqësore dhe ngritjen e çështjes së standardizimit të barazisë gjinore përmes të gjitha aspekteve të konfliktit, parandalimit të konfliktit, ruajtjen e paqes, pajtimin, dhe rindërtimin e pas luftës.

Gjatë këtyre takimeve, kemi identifikuar çështje rajonale dhe kombëtare që kanë të bëjnë me gratë, luftën dhe paqen. Ne po ashtu diskutuam mënyrat e përdorimit të Rezolutës 1325 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara në punën tonë, si dhe mundësitë dhe kërcënimet për zbatimin e Rezolutës 1325 në rajon e vend.

Anëtarët e RRGK-së, janë takuar me përfaqësuesit nga Rrjeti i Grave të Maqedonisë, me 25-26 tetor, në Prishtinë. Takimi është organizuar në bashkëpunim me Fondacionin gjerman Friedrich Naumann, organizatë gjermane.

Në nëntor, një delegacion nga Rrjeti i Grave të Bosnjës e Hercegovinës vizitoi anëtarët e RRGK-së në Prishtinë. Kjo vizitë u organizua e financua nga Kvinna till Kvinna.

RRITJA E PJESËMARRJES POLITIKE TË GRAVE

PARTITË POLITIKE PUNOJNË PËR GRATË

Fushata synon të përfshijë preferencat dhe idetë e grave në platformën elektorale të partive politike për zgjedhjet e përgjithëshme të vitit 2004. Për të arritur këtë prej nëntorit të 2003 e deri në mars të 2004, rrjeti ka organizuar takime me gra në 30 komuna të Kosovës. Morën pjesë gra nga politika, shoqëria civile dhe nga gjithë komunitetet etnike. Si rezultat u formuan 30 grupe avokimi të grave, nga një për secilën komunë. Këto grupe zhvilluan takime me gra në komunat e tyre, ku diskutuan për prioritetet dhe brengat që ato kishin. Më shumë se 1000 gra ishin pjesëmarrëse në këto takime. Bazuar në këto diskutime Grupet Avokuese të Grave, përpiluan platforma të referencave politike të grave, të cilat më vonë iu dorëzuan partive politike. RRGK dhe OSBE organizuan një tryezë të rrumbullakët për promovimin e publikimit “Gratë Propozojnë”, i cili publikim përfshinte rekomandimet e grave. Kordinatorë e RRGK të fushatës ishte Shqipe Pantina. Mbulimi i gjerë i fushatës nga ana e mediave elektronike dhe të shkuara, në nivel lokal e kombëtar, kontribuoi dukshëm në suksesin e fushatës. Fushata u përkrah nga Departamenti për Demokratizim i OSBE dhe ndihmën teknike prej STAR dhe UNIFEM.



Broshura “Gratë Propozojnë” thekson rekomandimet e grave për platformat e partive politike.

FUSHATA AVOKUESE “GRATË PROPOZOJNË”



Përfaqeset e RRGK Violeta Selimi dhe Ighalle Rogova shpjegojnë fushatën “Gratë Propozojnë” në një konferencë shtypi me përfaqes të OSBE Sven Lindholm dhe përfaqesën e Zyres Zvicerane Barbara Burri.

Vazhdimi i fushatës së RRGK-së “Partitë Politike Punojnë për Gratë”, “Gratë Propozojnë”, vazhdoi të promovojë pjesëmarrje më të madhe dhe efektive të grave në zgjedhjet e vjeshtës 2004, dhe si votues dhe si kandidatë të të gjitha partive politike. Fushata përbëhej nga një varg mbledhjesh publike që bashkoi kandidatët femra dhe qytetarët në çdo komunë. Violeta Selimi ishte kordinatorë e fushatës. Fushata u përkrah nga OSBE dhe Zyra Zvicerane për Bashkëpunim dhe Zhvillim (SDC). Me ndihmë teknike nga STAR Network of World Learning dhe UNIFEM.

FUSHATA E LIGJIT REFORMUES NË KOSOVË

Në mars 2004, RRGGK-ja së bashku me Lobin e Grave të Kosovës, iu bashkangjitën koalicionit për ligjin reformues zgjedhor, REFORMA-2004. Këtu përfshihej shkrimi i letrave për vendim marrësit kryesor lokal dhe ndërkombëtar, takime, fushatë mediash, konferenca për shtyp, debate televizive, fushata për edukim publik, si dhe protesta paqësore në 6 rajone për të përkrahur sistemin e ri zgjedhor të promovuar nga koalicioni i ligjit reformues zgjedhor në Kosovë. Sistemi i rekomanduar kombinonte paraqitjen gjeografike përmes rajoneve zgjedhore dhe balancimin e barazisë gjinore. Fushata gjerësisht mbulohej nga mediat elektronike dhe të shkruara. Edhe pse Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë nuk ndryshoi ligjin për zgjedhjet e vjeshtës së vitit 2004, fushata kishte sukses në ngritjen e vetëdijes publike dhe kontriboi që këto çështje të ligjit reformues zgjedhor të dalin në diskutimet politike në Kosovë.



Si pjesë e fushatës “Reforma 2004” qytetarët e Prishtinës protestojnë për reformimin e ligjit zgjedhor.

FUSHATA “DIL DHE VOTO”

Fushata, “Dil dhe Voto” u organizua në shtator dhe tetor të vitit 2004 me qëllim të inkurajimit më të madh për pjesëmarrje në votim në zgjedhjet e 23 tetorit. Fushata është financuar nga OJQ-ja kosovare Projekti për Avokim (KNAP), në bashkëpunim të ngushtë me Institutin Kombëtar Demokratik (NDI). Qëllimi i fushatës ishte rritja e pjesëmarrësve në votime dhe përmirësimi i njohurisë së qytetarëve për rëndësinë e votimit në zgjedhjet e ardhshme. Për qëllime të Fushatës u përdorën mediat, pamfletet, posterët, lajmërimet dhe propaganda. Roli i RRGGK ishte që aktivisht të përfshijë mediat lokale në mënyrë që fushata të ketë audiencë edhe më të madhe. Anëtarët e RRGGK-së i kanë ftuar liderët e komunitetit që të dalin në debate televizive, në lajme dhe në ngjarje të tjera mediale, në mënyrë që të inkurajojnë qytetarët që të votojnë. Ne dëshirojmë tu shprehim falënderimin tonë mediave lokale që kanë krijuar hapsirë dhe ofruar mundësi që fushata të jetë e suksesshme.



MEKANIZMAT LIGJOR PËR BARAZI GJNORE

PLANI KOMBËTAR I VEPRIMIT PËR BARAZI GJNORE

RRGGK-ja ka qenë partner udhëheqës në përpjekjet avokuese për përvetësimin e Planit Kombëtar të Veprimit (PKV) për arritjen e barazisë gjinore, nga ana e qeverisë së Kosovës. Me 21 janar 2004 gjatë takimit me kryeministrin e Kosovës Bajram Rexhepi, përfaqësuesit e RRGK-së paraqitën PKV, ku përfshiheshin rekomandime për fuqizimin e grave brenda partive politike dhe rritjen e numrit të grave në politikë dhe qeveri. Me 14 prill 2004, qeveria e përvetësoi planin. Qeveria ka filluar zbatimin e planit, por RRGK-ja vazhdon të avokojë për zbatim të plotë. Ndihma teknike dhe financiare u sigurua nga UNIFEM.

KONFERENCA MEKANIZMAT PËR BARAZI GJNORE

Konferenca “Mekanizmat e Barazisë Gjinore”, që u mbajt me 17-18 shtator ishte iniciativë e përbashkët e organizuar nga zyra e Kryeministrit për Qeverisje të Mirë, të Drejtat e Njeriut, Mundësi të barabarta dhe Barazi gjinore, RRGK-ja, Departamenti i Demokratizimit i OSBE-së, UNIFEM, dhe Zyra për Çështje Gjinore-UNMIK. Konferenca u organizua në kontekstin e shpalljes së ligjit të ri për barazi gjinore. Kjo siguronte forumin e mbrojtësve dhe ekspertëve për avancimin e barazisë gjinore në nivel lokal dhe qendror, rishikimin e mekanizmave për barazi gjinore dhe diskutimin e ndryshimeve ose veprimeve për institucionalizimin e mëtutjeshëm të këtyre mekanizmave.

TË DREJTAT E GRAVE

LILJA FOREVER

Bazuar në filmim “Lilja 4-ever” (Lilja përgjithmonë) nga regjisori Suedez Lukas Mudison, u nis fushata e ngritjes së vetëdijes së çështjes së trafikimit të grave dhe vajzave. Filmi përshkruan jetën dhe përvojat e femrave të reja nga Evropa qendrore dhe lindore të cilat bëhen viktima të trafikimit seksual. Nga shkurti deri në dhjetor 2004, filmi është shfaqur në Prizren, Ferizaj, Gjakovë dhe Gjilan. Projekti është financuar nga SIDA Suedeze dhe e organizuar në bashkëpunim me misionin e OSBE-së në Kosovë, Shkollën e Shërbimit Policor, IOM-i, Qendra për Mbrojtjen e Grave dhe Fëmijëve, Rrjeti i Grave Serbe - Zora, Qendra për Mbrojtjen e Viktimave dhe

Parandalimin e Trafikimit të Qenieve Njerëzore dhe Kvina Forum. Ky projekt është pjesë e përpjekjeve të RRGK-së për të tërhequr vëmendjen dhe ngritur vetëdijen e politikanëve, policëve, autoriteteve, punëtorëve social, gazetarëve dhe publikut rreth tregtisë seksuale. “Lilja 4-ever” është në dispozicion në DVD në tri gjuhë nga SIDA.



FUSHATA “TË NJOHIM TË DREJTAT”

Plani Kombëtar i Veprimit, Ligji për Barazi Gjinore, Ligji Kundër Diskriminimit, dhe Ligji për Familjen, të gjitha të shpallura në vitin 2003-2004, janë të arritura të mëdha për barazi gjinore. Këto mundësojnë promovimin dhe mbrojtjen e drejtave të njeriut në Kosovë. Megjithatë, problemet shoqërore si dhuna ndaj grave, trafikimi i femrave, shkalla e ulët e grave të regjistruara në shkolla dhe universitete, shkalla e lartë e varfërisë tek femrat, diskriminimi gjinor në botën e biznesit, dhe mungesa e femrave në politikë, ende e rëndojnë gjendjen në Kosovë. Gjersa mekanizmat gjinore ekzistojnë në nivelin politik, shumë meshkuj dhe femra nuk kanë dijeni për të drejtat e tyre, se si ti qasen mbrojtjes e cila u sigurohet me ligjet e reja, apo se si të përdorin shërbimet e Ombudspersonit. Kështu që, zbatimimi i ligjeve dhe realizimi i plotë i potencialit për ndryshime sociale mbetet i vështirë.

Fushata “Të njohim të Drejtat” ka për qëllim të informojë qytetarët për të drejtat e tyre dhe mekanizmat ekzistues për çështjet gjinore përmes programeve artistike. Pesë aktore të njohur kosovare janë

mbledhur për të demonstruar tregimet, të cilat sqarojnë mekanizmat gjinore të përmendur më herët. Artistet kanë shfrytëzuar mediat e popullarizuara, duke përfshirë lojën teatrale dhe RRGGK-në si një mjet edukimi, me shpresë të arritjes sa më të mirë gjer te qytetarët Kosovarë. Aktoret kanë përdorur monologun dhe dialogun për të bashkëbiseduar drejtëpërdrejtë me audiencën dhe për tërheqjen e audiencës në lojën artistike të aktoreve. Dialogjet në mes të artisteve kanë shpalosur përvojat e femrave, duke portretizuar situatat në të cilat mekanizmat gjinore mund të përdoren. Storit teatrale janë bazuar në ngjarje të vërteta nga përvojat e grave.

Fushata ka filluar me 29 nëntor në Prishtinë, duke shënuar Ditën Ndërkombëtare Kundër Dhunës Ndaj Gruas. Shfaqja është përsëritur në Prizren me 2 dhjetor dhe në Mitrovicë me 3 dhjetor. Fushata do të vazhdojë në 2005 nëpër të gjitha komunat e Kosovës. Ky projekt financiarisht ka qenë i mbështetur nga UNIFEM. RTV 21 ka qenë sponsor medial.



Gjatë një shfaqje të fushatës “Të njohim të drejtat”, artistet e njohura bashkëbisedojnë me gratë nga viset malore të Hasit.

IMPLEMENTIMI I REZOLUTËS 1325 TË KËSHILLIT TË SIGURIMIT

Si rrjedhojë e bisedimeve nismëtare të mbajtura në shkurt në Prishtinë, lidhur me zbatimin e rezolutës 1325 të Kombeve të Bashkuara, në Sarajevë në tetor 2004 është mbajtur një seminar regional për zbatimin e kësaj rezolute.

Seminari është mbajtur dhe financuar në partneritet me UNIFEM dhe Kvinna till Kvinna. Gra nga Kosova, Serbia

dhe Mali i Zi, Kroacia, Bosna dhe Maqedonia kanë diskutuar strategjitë për implementimin e rezolutës 1325 të Kombeve të Bashkuara në rajon. Si rezultat i seminarit u përpilua një letër e përbashkët për Këshillin e Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, e cila shpreh mbështetjen e pjesëmarrësve për zbatimin e rezolutës 1325. Gjithashtu u punua një draft i planit të veprimit për përpjekjet ardhëshme në këtë drejtim.

PROGRAME TË TJERA

PÛRKRAHJE E TË USHQYERIT ME GJI

Projekti “Grupi i përkrahjes gratë për gratë për nënat që i ushqejnë me Gji” ka filluar në tetor 2004 dhe do të përfundojë në mars 2005. Projekti është realizuar në bashkëpunim me UNICEF-in, grupin punues të BFHI-së dhe OJQ-ve lokale. Projekti i financuar nga UNICEF-i ka pasur për qëllim rritjen e shkallës së të ushqyerit me gji me vendosjen e përkrahjes funksionale dhe të qëndrueshme “Gratë për Gratë” në gjashtë lokacione. Grupet mbështetëse së pari përkrahën, mbrojtën, dhe promovuan të ushqyerit me gji në nivelin e komunitetit.

RRGGK krijoi dhe ka mbajtur komunikim të afërt me repartin e lehonisë në mënyrë që të mbledhin informata për nënat e reja dhe nëse është e nevojshme, të i vizitojnë ato në shtëpi. Grupi përkrahës është konsultuar me nënat, gratë dhe familjet për rendësin e të ushqyerit me gji dhe për mirëmbajtjen e qumështit të gjirit. Diskutimet u zhvilluan në qendrat dhe zyrat e OJQ-ve, si dhe përmes konsultimeve telefonike apo edhe me vizita shtëpiake.

RRGGK ofron informata dhe konsultime për të ushqyerit me gji me vëmendje të veçantë për gratë nga komuniteti rom, ashkali dhe egjiptian, si dhe gratë që jetojnë në zonat rurale.

FONDACIONI I GRAVE KOSOVARE

Në qershor dhe tetor të 2004, Bordi i RRGK-së, personeli dhe partnerët u takuan për të diskutuar idenë e themelimit të Fondacionit të Grave Kosovare si një mekanizëm financues për grupet e grave në Kosovë. Në takim u themeluan grupe punuese për mbledhje të fondeve, çështjeve organizative me prioritetet programore për zhvillimin e mëtutjeshëm të idesë Fondacioni i Grave Kosovare. RRGK i ka dorëzuar propozime UNIFEM-it dhe KFOS-it për zhvillimin e një pilot projekti për themelimin e një fondi të tillë.

PROGRAMET E ARDHSHME

Në vitin 2005 RRGGK do të fokusohet në shtimin e shërbimeve për anëtarësinë dhe në ngritjen e kapaciteteve të Rrjetit për avokim. RRGGK do të vazhdojë të ofrojë asistencë teknike dhe përkrahje OJQ-ve të grave minoritare në Kosovë. Gjithashtu RRGGK do të vazhdojë programet që ka filluar në 2004 si dhe do të iniciojë disa programe të reja.



RRGGK do të vazhdojë ti përfshijë anëtarët e veta në planifikimin strategjik në programet e ardhshme.

SHËNDETI I GRAVE

RRGGK do të vazhdojë me fushatën për ngritjen e vetëdijes për rëndësinë e të ushqyerit me gji për nënat e reja. Përveq kësaj RRGGK do të realizojë një fushatë të re që do të ngrisë vetëdijen për mënyrat e parandalimit të kancerit në gji, si dhe inkurajimin e grave që të bëjnë mamografi të rregullta dhe vet ekzaminime.

FONDACIONI I GRAVE

RRGGK do të fillojë një proces afatgjatë drejt themelimit të Fondacionit të Grave Kosovare me asistencë teknike dhe financim nga UNIFEM dhe Urgent Action Fund.

ZËRI I GRAVE NË VENDIM-MARRJE

RRGGK do të ndërmarrë tri veprime në këtë fushë. Rrjeti do të bëhet partner me agjensitë e Kombeve të Bashkuara në Kosovë për të hulumtuar statusin e grave, si njëri nga aktivitetet për arritjen e Qëllimeve Zhvillimore të Mileniumit.

RRGGK do të vazhdojë fushatën “Të njohim të Drejtat” për ngritjen e vetëdijes mbi mekanizmat ekzistues për çështje gjinore. Kjo do të edukojë qytetarët lidhur me Planin Kombëtar të Veprimit për Barazi Gjinore, Ligjin për Barazi Gjinore, Ligjin për Familje dhe për Ligjin Kundër diskriminimit, në mënyrë që të kenë mundësi ti përdorin këto ligje. Kjo do të përfshijë edhe fushatën për arsimimin e zyrtarëve shtetëror rreth mënyrave të zbatimit të Planit Kombëtar të Veprimit për arritje e Barazisë Gjinore, në partneritet me organizatat për Analiza Ligjore të çështjeve Gjinore.

RRGGK do të vazhdojë punën me fushatat “Gratë Propozojnë” dhe “Partitë Politike punojnë për Gratë”, duke përdorur Grupet lokale për Avokim Gjinor për përkrahje dhe bashkëpunim me femrat politike për përgatitje për zgjedhjet lokale të vitit 2006.

RRGGK do të vazhdojë të bashkëpunojë me OJQ-të tjera Kosovare për të avokuar ndryshimet në ligjin e tanishëm për zgjedhjet. Ndryshimet e propozuara përfshijnë shtatë qarqe regjione të votimit, përfaqësim gjinor dhe lista të hapura. Një sistem i tillë do të duhej tu mundësonte femrave ashtu edhe meshkujve që të zgjedhurit e tyre në qeveri të jenë më përgjegjës ndaj votuesve.

Përgatitje për mbajtjen e një konference ndërkombëtare mbi zbatimin e rezolutës së Kombeve të Bashkuara 1325, e cila mendohet të mbahet në fillim të 2006. RRGGK do të vazhdojë të bashkëpunojë me UNIFEM për të përgatitur një raport për të analizuar shkallën e zbatimit të kësaj rezolute në Kosovë.



Stafi i Rrjetit nga e majta në të djathtë: Hatixhe Ramosaj, Igballe Rogova, Elita Gota, and Shqipe Pantina



STAFI I RRJETIT

Igballe Rogova
Drejtoreshë

Elita Gota
Menaxhere e Programit

Shqipe Pantina
Koordinatorë e Fushatës “Partit Politike Punojnë për Gratë”

Violeta Selimi
Koordinatorë e Fushatës “Gratë Propozojnë”

Laura Ruhi
Koordinatorë e Fushatës “Gratë Përkrahin Gratë”

Hatixhe Ramosaj
Menaxhere Financiare



ANËTARËT TANË

ORGANIZATA	PERSONI KONTAKTUES	ADRESA E ZYRËS
Afrodita	Maria Kurti	Obori i shkollës “Jeronim De Rada”, Ferizaj
Alma	Shemsije Seferi	Sverkë, Pejë
Antigona	Rabe Rrustemi	Fehmi Lladrovci H/I Nr 26, Skenderaj
Ato	Naile Zahiti	Çamërija, Vushtrri
Aureola	Sanije Grajçevci	Jakov Xoxa 162, Prishtinë
Bagëti e Bujqësi, BeB	Zahide Gashi	Prishtinë
Bardha	Raza Sadrija	Mateja Gubec 45 A (Shaip Spahia), Prishtinë
Centari Romani Gjuvlenge	Emsale Mergjollari	Kadri Nesho Nr 26, Prizren
Dera e Hapur	Belgjyzare Muharremi	Dardania B I 1/5 kat/I Nr 1, Prishtinë
Dora Dorës	Vjosa Curri	Farketareve Nr 28, Prizren
Dua	Ilirijana Kryeziu	Lekë Dukagjini 24/A, Prizren
Elena Gjika	Lale Grabanica	Z. Hajdini Nr 5, Klinë
Femrat në Veprim	Igballe Hakiqi	Hakif Zejnullahu PN, Podujevë

ORGANIZATA	PERSONI KONTAKTUES	ADRESA E ZYRËS
Fillesa	Drita Myftiu	Prizren
Flaka	Shehindere Dedushi	Lipjan
Gruaja Bashkëkohore	Fetije Mehmeti	Bajo Populli 7, Prizren
Gruaja Familjare	Nadire Kryeziu	Haxhi Ymeri 10/17, Prizren
Gruaja Sot	Shyhrete Besimi	Mbreti Bardhyl 19, Prizren
Grupi i Veteranëve të Arsimit GVA	Naxhije Buçinca	Dardania Kat 1 Hy.11 Nr 112, Prishtinë
Hadër	Resmije Krasniqi	Adem Bajrami 2, Prizren
Handikos	Drita Vukshinaj	Zahir Pajaziti PN, Prizren
HANDIKOS, Femrat me Aftësi të Kufizuar	Mehreme Llumnica	Dardania B1/5, Prishtinë
Hanëmeli	Lirije Gash	TMK 101/7, Prishtinë
Hareja	Miradije Haxhijaha	Bujar Thaçi PN, Rahovec
Idemo Pravo	Zhivodinka Radosavlevic	Plemetin
IFK Vizioni i Ri	Ardita Rizvanolli	“Tirana” tranzit, Gjakovë
Jeta Ime	Shqipe Bejtullahu	Permet Vula 25, Gjakovë
Jeto Jetën	Xhylnaze Bytyqi	Vajzat e Sulit, Prizren
Kalabria	Sevdie Bunjaku	Marin Barleti Nr 2/9, Prishtinë
Kevser	Igballe Berisha - Huduti	Remzi Ademaj, Prizren
KHWA	Gjylfidane Morina	Dardanija I, Pejë

ORGANIZATA	PERSONI KONTAKTUES	ADRESA E ZYRËS
Komiteti i Grave të Verbëra, SHVPDK	Bajramshahe Jetullahu	Ali Hadri nr. 8A, Prishtinë
Koraci Buducnosti	Smiljana Veselinovic	Gračanicë
Kosovarja	Ferjalle Vula	Gjakovë
Kosovarja Prizrenase	Dita Arapi	Lekë Dugagjini 46, Prizren
Kryefamiljarja	Sevdije Sadiku	Lagja e Re 5, Suharekë
Legjenda	Melihate Osmani	Viti
Lepsa Buducnost	Radosava Mirkovic	Priluzje
Liria	Nazife Jonuzi	7 Koriku 16/2, Gjilan
Liria	Luljetë Kuqi	28 Nëntori PN, Suharekë
Lufto Jetën	Nezaqete Idrizi	Karllocit 3, Prizren
Lulebora	Selvete Gashi	Keramikes Nr 9b, Prishtinë
Lulishtja	Sadije Dulahu	Keqekollë, Dabishevc
LWF	Shyhrete Peci	Agim Ramadani, Shipol, Mitrovicë
Medica Kosova	Flutura Zajmi	Luigj Gurakuqi 39, Gjakovë
Motrat Qiriaz	Marte Prekpalaj	Has, Prizren
Ne Jemi Pjesë e Botës	Atifete Demaj	Nënë Terezë, Fushë Kosovë
NORMA	Valbona Salihu	Fakulteti Juridik, Kati IV, Prishtinë
OJQ e femrave për hulumtime Etnologjike	Shpresa Siqeca	Komuna e Parisit 14, Prizren

ORGANIZATA	PERSONI KONTAKTUES	ADRESA E ZYRËS
One to One - QKGFF	Merita Halitaj	Sahat Kulla 66, Prizren/17 Nentori 65, Pejë
Organizata e Gruas “Fortesa”	Saniye Jahiri	Kamenicë
Organizata E Gruas Së Pamvarur OGPK	Rudina Gerdec Llapashtica	Zija Shemsiu 23, lagja Ulpiana, Prishtinë
Organizata per Aktivitete Zhvillimore ODA	Violeta Selimi	Ferat Dragaj 39/A, Aktash II, Prishtinë
OPER	Nurije Ferati - Haziri	Abdullah Presheva PN, Prishtinë
Promocom	Shpresa Mazreku	Bujar Thaqi PN, Rahovec
PVPT/QMVPT	Belkez Dedolli Ferri	Prishtinë
Qendra Kosovare për Studime Gjinore	Luljeta Vuniqi	Bulevardi i Dëshmorëve 19/3, Prishtinë
Qendra për Gra dhe Fëmijë ASEBE	Elita Reshtani	Milan Shuflai 4, Prizren
Qendra për Mirëqenien e Gruas QMG	Lumnije Decani	17 Nëntori 59, Pejë
Qendra për Trajnime dhe Studime Gjinore	Arjeta Rexha	Ulpiana U I/H2 Nr 10, Prishtinë
Qendra Resurse e OJQ-ve	Esmat Smajli	Ismet Jashari Kumanova, Prizren
QMGF/CPWC	Sevdije Ahmeti	Rexhep Mala 8A, Prishtinë
REA	Reafete Rexhepi	Muhocë, Ferizaj
Ruka + Ruci	Nevenka Rikallo	Fushë Kosovë
Sara	Dashurije Sahiti	Bresanë, Dragash
SHE-ERA	Mirlinda Kusari	“Tirana” tranzit, Gjakovë
Shoqata e Gruas	Mybera Valla	Washingtoni PN, Gjakovë

ORGANIZATA	PERSONI KONTAKTUES	ADRESA E ZYRËS
Shoqata Gruas “Zana”	Tahire Gashi	Klinë
Shoqata e Gruas dhe e Fëmijëve “NARDI”	Violeta Shehu	Bajram Kelmendi 21, Prishtinë
SH.P.I.A.	Kismete Hyseni	Pashko Vasa (lagja Pejton), Prishtinë
Shtëpia e Sigurtë	Sakibe Doli - Dobruna	Gjergj Fishta PN, Gjakovë
Sibora	Hyrmete Celina	Ardian Zurnagjiu 35, Prizren
Teuta	Nexhmije Bytyqi	Remzi Ademi, Prizren
Violete	Bedrije Shala	Barilevë, Prishtinë
Vita - Jeta	Sanije Bajrami Nimani	Haxhi Zeka Nr 62, Prishtinë
Women for Women International	Hamide Latifi	UCKNr 17, Prishtinë
Yllka	Zejnepe Recica	Sazli, Ferizaj



RAPORTI FINANCIAR


DONATORI	PROJEKTI / FUSHATA	SHUMA (EURO)
Star Network of World Learning	Ngritja e Kapaciteteve	8262.87
Kosovo Foundation for an Open Society	Ngritja e Kapaciteteve	8760.00
Kosovo Local Initiative Program	Ngritja e Kapaciteteve	19,700.00
Organization for Security and Cooperation in Europe	Partitë Politike Punojnë për Gratë	26,400.00
Organization for Security and Cooperation in Europe	Gratë Propozojnë	20,000.00
Swiss Cooperation Office	Gratë Propozojnë	12,950.00
United Nations Children's Fund	Gratë Përkrahin Gratë	26,280.00
Sweedish Agency for International Development and Cooperation	“Lilja Forever” Fushata kundër Trafikimit të Femrave	7,150.00
United Nations Fund for Women	Fushata Gratë Propozojnë	1,720.00
STAR Network of World Learning	Fushata Gratë Propozojnë	395.85
Foundation for Democratic Initiatives	Fushata për Reformat Zgjedhore	5,000.00
United Nations Fund for Women	Konferenca për Mekanizmat e B.GJ.	7,650.00
Total		144,268.70

SHPENZIMET OPERATIVE

SHPENZIMET	PROJEKTI	SHUMA (EURO)
Pagat	Ngritja e Kapaciteteve të RRGK	16,031.00
Pajisjet	Ngritja e Kapaciteteve të RRGK	3,473.19
Shpenzime të Zyres	Ngritja e Kapaciteteve të RRGK	3,719.49

SHPENZIMET E PROGRAMEVE DHE TË ZYRËS GJATË 2004

Shpenzimet e Programeve
121,045.04
84%



Shpenzimet e Zyrës
23,223.68
16%



Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës
Adresa: Rr. Agim Ramadani, Nr. 50/8
Prishtinë, Kosovë
www.womensnetwork.org